



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencija za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture
Development Agency**

DIVIZIONI PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ DIVIZIE ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/
/DIVISION OF PUBLIC COMMUNICATION/

THIRRJE PËR APLIKIM

Për pagesa direkte në blegtori për vitin 2014
(Lopë, buallica, dele dhe dhi në prodhimtarinë aktive të qumështit, dosa për
riprodhim dhe bletë)

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit do të vazhdojë të mbështes sektorin e blegtorisë përmes pagesave direkte. Niveli i mbështetjes do të jetë:

- **Pagesa direkte - Lopë dhe Buallica qumështore 50 € /krerë**
- **Pagesa direkte - Dele dhe dhi qumështore 10 € / krerë**
- **Pagesat direkte - Dosa për riprodhim 20 € / krerë**
- **Pagesat direkte - Bletë 10 € / shoqëri bletësh (koshere)**

Fermerët që aplikojnë duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë minimum 5 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore ose gjithsej 5 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore së bashku dhe në maksimum 50 krerë në prodhimtarinë aktive të qumështit;
- Të kenë minimum 30 krerë dhe në maksimum 500 krerë dele në prodhimtarinë aktive të qumështit;
- Të kenë minimum 20 krerë dhe në maksimum 500 krerë dhi në prodhimtarinë aktive të qumështit;
- Të kenë minimum 30 shoqëri bletësh dhe në maksimum 500 shoqëri bletësh (koshere);
- Të kenë minimum 2 krerë dosa për riprodhim;

- Kafshët duhet të jenë të matrikuara me matrikul të Republikës së Kosovës ose me matrikul të vendeve anëtare të BE-së;
- Bletarët mund t'i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) më së shumti në tri (3) bletishte;
- Kosheret duhet të jenë të shënjuara me numër identifikues të pronës, sipas një rregullimi të brendshëm nga MBPZHR-ja (lidhur me këtë fermerët do të njoftohen në momentin e aplikimit).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fotokopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit;
- Regjistrin e lëshuar nga praktikant veterinarë të kontraktura nga AUV-ja, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit & Regjistrimit të kafshëve në AUV, për lopët qumështore, buallicat qumështore, delet qumështore, dhitë qumështore dhe dosat për riprodhim.
- Dëshminë që është i regjistruar në regjistrin e fermës;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë;
- Fotokopjen e certifikatës për prodhimin organikë të mjaltit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga trupa certifikues;
- Fermerët e certifikuar për prodhimin organikë të mjaltit, fotokopjen e certifikatës duhet t'ia bashkëngjisin dokumentacionit jo më larg se 10 ditë nga data e certifikimit.

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 30 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes së thirrjes për aplikim.

Aplikimi duhet të bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi.

Mënyra e aplikimit:

Të gjithë fermerët fillimisht, gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për regjistrim në Regjistrin e fermerëve, i cili është parakusht për përfitimin e mbështetjes.

- Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

Sqarim:

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.
- Fermerët bletarë të certifikuar për prodhimtari organikë të mjaltit subvencionohen në shume prej **15 euro /shoqëri bletësh (koshere)**.
- Regjistrin e kafshëve fermerët mund ta marrin në stacionet e autorizuar nga AUV-ja sipas tabelës në vijim:

	Operatoret ekonomik të kontraktuar për shërbimet veterinare në terren	Vendi i kryerjeve të shërbimeve	Emri i Pronarit	Nr. i telefonit	E-mail
1.	N.SH "VETERINA" Lot 1	PRISHTINE	SHEFKI AJDINI	044 201 082	shefkiajdini@hotmail.com
2.	A.V "VETERINARIA" Lot 2	MITROVIC	AVNI KADRIU	044 196 693	avnikadriu@gmail.com
3.	A.V "KOSOVA-NOR" Lot 3	PEJË	TAULANT KASTRATI	044 149 409	taulantikastrat@yahoo.com
4.	A.V "J&R" Lot 4	PRIZREN	JANUZ DURAI	044 279 802	dr.durajjanuz@hotmail.com
5.	N.T.SH "FAUNA" Lot 5	GJILAN	SHQIPTON SELIMI	044 820 793	administrata@fauna-ks.com
6.	A.V "JONI" Lot 6	RAHOVEC	SALI THAQI	044 188 186	thaqisal@hotmail.com
7.	S.V "ENKELI MED VET" Lot 7	MALISHEV	AVNI ROBAJ	044 141 925	avni.robaj@gmail.com
8.	A.V "SIPI" Lot 8	KLINE	JOSIP TOPLANAJ	044 232 474	sipi_73@hotmail.de
9.	N.SH " FAUNA" Lot 9	SKENDERAJ	ISTREF GASHI	044 192 149	istrefig@hotmail.com
10.	N.SH " AMBULANCA E VETERINARIS" Lot 10	SUHAREKË	KRESHNIK RUGOVA	044 140 409	kreshnikro@yahoo.com
11.	A.V "M&N" Lot 11	ISTOG	MENTOR LLULLAKU	044 281 572	-----
12.	O.V "QERIM PEP SHI" Lot 12	DEÇAN	QERIM PEP SHI	044 949 561	cbesian@gmail.com
13.	A.V "DARDANI" Lot 13	GJAKOVE	ALBERT HASANAJ	044 494 483	bertkosova@hotmail.com
14.	N.SH "VETERINA" Lot 14	FUSHE KOSOVA	SHEFKI AJDINI	044 126 439	shefkiajdini@hotmail.com
15.	S.V "VETERINA" Lot 16	VUSHTRRI	SAFET OSMANI	044 147 297	safetosmani33@hotmail.com
16.	K.F.V "SIMENTAL" Lot 17	VITI	ARSIM ADEMI	044 284 006	valonsherifi01@hotmail.com
17.	A.V "VETERINA" Lot 18	KAMENIC	ARBEN SINANI	044 300 605	arbensinani78@hotmail.com
18.	N.SH "STACIONI VETERINAR" Lot 19	DRAGASH	REXHEP SHALA	044 201 082	rexhepshala@hotmail.com
19.	A.V VETERINA" Lot 20	DRENAS	SEFEDIN HETA	044 180 947	dr.sefedinheta@hotmail.com
12.	A.V "VETERINARI" Lot 21	PODUJEV	HAMDI ALIU	044 313 369	dmv_hamdi@hotmail.com
21.	D.T.SH "AS VET" Lot 22	JUNIK	FLORIK HAXHIKADRIJA	044 610 474	h_florik@hotmail.com
22.	A.V "BERATI" Lot 25	NOVËBERDË	QERIM SADIKU	044 222 560	qerim_sadiku@hotmail.com
23.	N.SH "MEDICAL" Lot 26	OBILIÇ	URAN REXHEPI	044 375 775	urani112@hotmail.com
24.	K.V "VETERINA-MED" Lot 27	SHTERPCË	HYZRI YMERI	044 324 656	
25.	V.S "VETKOS" Lot 31	RANILLUG	DRAGAN PANDOVIC	044 511 041	-----
26.	V.A "KOSVET" Lot 32	PARTESH	LJUBISA RISTIC	045 621 952	-----
27.	K.F.V "SIMENTAL" Lot 33	KLLOKOT	ARSIM ADEMI	044 284 006	valonsherifi01@hotmail.com
28.	A.V "VETERINA" Lot 34	GRÇANIC	BUJAR EJUPI	044 206 986	bujar@yahoo.com
29.	A.V "PRAXIS VETERINA" Lot 35	MAMUSH	ARSIM HIMBEQA, M. TOPOJANI, E. BEGU	044 217 454	vetpz@yahoo.com
30.	A.V "KUJDESI" Lot 36	KAÇANIK	ISAMEDIN SOPA		isamedinsopa@hotmail.com
31.	A.V "MEDICA" Lot 37	HANI I ELEZIT	SADAT BAJRAMI	044 455 355	sadi-ba@hotmail.de

